



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**  
*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*  
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*  
*Ministry of Local Government Administration*

Për :	Agim Aliu, Kryetar i Komunës së Ferizajt Kristina Gashi Bytyqi, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Ferizajt	
Kopje:	Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në Komunë Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave -MAPL	
Përmes: <i>PELi</i>	Ivan Todosijević, Ministre e MAPL-së Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme e MAPL-së, <i>B. Kuni</i>	
Nga:	Shkëlqim Jakupi Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorimit të Komunave, MAPL <i>-Aliu</i>	Date: 04/07/2018
Lënda:	Kërkesë për rishqyrtimin e ligjshmërisë së aktit të komunës së Ferizajt	020-746
Lloji i aktit:	Vendim i kuvendit të Komunës	

I nderuar Kryetar,  
E nderuara Kryesuese,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 01/2016 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendimi Nr.107 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të tokës së komunës ngastra kadastrale 708-2, Z.K. Ferizaj.
I miratuar më datë: 28.06.2018
I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 29.06.2018

Ministria e Administrimit të Pushteti Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës është në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

Mos pajtueshmëritë e aktit të komunës të parashtruar për shqyrtim të ligjshmërisë janë si në vijim:



Nr.	Formulimi në aktin e komunës	Dispozita ligjore me të cilën akti i komunës është në kundërshtim.
1.	Vendimi Nr.107 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të tokës së komunës ngastra kadastrale 708-2 Z.K. Ferizaj.	<p>Vendimi Nr.107, për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të tokës së komunës ngastra kadastrale 708-2 Z.K, Ferizaj është në kundërshtim me Ligjin Nr. 04/L-144, për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës përkatësisht Nenin 9.1 të këtij ligji si dhe nenin 18.2 të Rregullores (QRK) Nr. 23/2013, për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të komunës pasi që në procesin e votimit ky vendim është miratuar më 19 vota pro asnjë kundër dhe 5 abstenime.</p> <p>Në rastin konkret vendimi miratohet më se paku 21 vota për nga gjithsejtë 41 anëtarët e kuvendit të komunës së Ferizajt.</p> <p>Po ashtu ky vendim është në kundërshtim më nenin 10 pika 1 e Ligjit Nr. 04/L-144 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës pasi që këtij vendimi i mungon kërkesa për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale nga institucionet qendrore të Republikës së Kosovës ashtu siç përcaktohet më këtë ligj.</p>

Bazuar në të cekurat më lartë, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal *kërkon* nga Kuvendi i Komunës/Kryetari i Komunës së Ferizajt, që të ndërmarrin veprime konkrete që aktin e komunës ta harmonizojnë me dispozitat ligjore në fuqi, brenda 30 ditësh nga data e pranimit të kërkesës për rishqyrtim të aktit.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejme në lidhje me këtë vlerësim.



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**  
*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*  
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*  
*Ministry of Local Government Administration*

Za:	Agim Aliu, gradonačelnik Opštine Uroševac Kristina Gashi Bytyqi, predsedavjuća Skupštine opštine Uroševac	
Kopija:	Jedinici za administraciju dokumenata u MALS-u Jedinici za administraciju dokumenata u opštini	
Preko:	Ivan Todosijević, ministar MALS-a, Rozafa Ukimeraj, generalna sekretarica MALS_a, 	
Od:	Shkëlqim Jakupi, rukovodilac Odeljenja za zakonska i monitorisanje opština, MALS 	Datum, 4.07.2018. Br: 020-746
Predmet:	Zahtev za reviziju zakonitosti akta opštine Uroševac	
Vrsta akta:	Odluka Skupštine opštine	

Poštovani gradonačleniče,  
Poštovana predsedavajuća,

U saglasnosti sa uredbom Vlade Republike Kosova br. 01/2016 za administrativno razmatranje akata opštine i na osnovu zakonskih ovlašćenja određenim osnovnim zakonima i uredbom Vlade br. 02/2011 o poljima odgovornosti administrativne Kancelarije premiera i ministarstva, Odeljenje za zakonska pitanja i monitorisanje opština MALS-a, primio je za obavezno razmatranje zakonitosti akta opštine kako je predviđeno članom 81. Zakona br.03/L-040 o lokalnoj samoupravi kao u nastavku:

Odluka br.107 za davanje na dugoročno korišćenje opštinskog zemljišta katastralna parcela 708-2 K.Z. Uroševac.
Usvojena dana, 28.06.2018. godine,
Predložena za razmatranje u MALS-u, dana, 29.06.2018. godine,


MALS, nakon razmatranja sadržaja gore navedenog akta opštine, ocenjuje da je isti u suprotnosti sa zakonskim odredbama na snazi.

U nastavku možete naći neslaganja opštinskog akta koji je dostavljen za razmatranje zakonitosti:

Br.	Formulisane u aktu opštine	Zakonska odredba sa kojom je akt opštine u suprotnosti.
1.	Odluka br.107 za davanje na dugoročno korišćenje opštinskog zemljišta katastralna parcela 708-2 K.Z. Uroševac.	<p>Odluka br.107, za davanje na dugoročno korišćenje opštinskog zemljišta, katastralna parcela 708-2 K.Z, Uroševac je u suprotnosti sa Zakonom br.04/L-144 o davnju na korišćenje i razmenu nepokretne imovine opštine, odnosno članom 9.1 ovog zakona kao i članom 18.2 Uredbe Vlade (VRK) br. 23/2013, o određivanju procedura davanja na korišćenje i razmenu nepokretne imovine opštine, pošto u procesu glasovanja, ova odluka je usvojena sa 19 glasova "za" nijedan glas "protiv" i 5 suzdržanih.</p> <p>U konkretnom slučaju odluka se usvaja sa najmanje 21 glasova od ukupno 41 članova Skupštine opštine Uroševac.</p> <p>Takođe, ova odluka je u suprotnosti sa članom 10 tačka 1 Zakona br. 04/L-144 o davanju na korišćenje i razmenu nepokretne imovine opštine, pošto ovoj odluci nedostaje zahtev za davanje na korišćenje opštinske imovine od strane centralnih institucija Repulike Kosovo, kao što se određuje sa ovim zakonom.</p>

Iz gore navedenog, Ministarstvo administracije lokalne samouprave od Skupštine opštine i gradonačelnika opštine traži da preduzimaju konkretne delatnosti kako bi akt opštine uskladile sa zakonskim odredbama na snazi, unutar predviđenog roka od 30 dana, od dana prijema akta za ponovnu raspravu.

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, ostaje na raspolaganju opštini za daljna objašnjenja u vezi sa ovom procenom.



REPUBLIKA E KOSOVES • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

KUVENDI I KOMUNES  
SKUPŠTINA OPŠTINE  
MUNICIPAL ASSEMBLY

01.Nr. 107  
Datë: 28.06.2018

Në bazë të nenit 12, paragrafit 12.2, pika d dhe nenit 14, paragrafit 14.1 të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 28/15, qershor 2008), të nenit 10, të Ligjit 041-1/11, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 35/17, dhjetor 2012), të nenit 20 të Rregullorës së QRK-së nr. 23/2013, për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, nenit 10, paragrafit 2 nënparagrafi 2.4 të Statutit të Komunës së Ferizajt 01. Nr. 50 të datës, 28.06.2013 Kuvendi i Komunës në seancën e mbajtur me datën, 27.06.2018 miratoi:

#### V E N D I M

#### PËR DHËNIE NË SHFRYTËZIM AFATGJATË TË TOKËS SË KOMUNËS, NGASTRA KADASTRALE 708-2, Z.K FERIZAJ

- I. Miratohet propozimi i kryetarit të Komunës, për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim, Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës (SHSKUK)-Qendrës për Shëndet Mendor me Shtëpi Integruese në Bashkësi Ferizaj pa procedurë të konkurimit.
- II. Sipas vendimit të cekur në pikën I pronë e paluajtshme të Komunës e ngastrës kadastrale 708-2 me sipërfaqe prej 1000 m<sup>2</sup> Zona Kadastrale Ferizaj vendi i quajtur "Vata" i ipet në shfrytëzim, Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës (SHSKUK)-Qendrës për Shëndet Mendor me Shtëpi Integruese në Bashkësi Ferizaj
- III. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës të cekur në pikën II të këtij vendim, është ndërtimi i shtëpisë integruese për rehabilitimin dhe risocializimin e klientëve me çrregullime mendore.
- IV. Afati për dhënien e pronës të cekur në pikën II sipas këtij vendimi është afatgjatë për 99 (nëntëdhjetë e nëntë) vite pa pagesë.
- V. Kontrata për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës për rastë të veçanta, nënshkruhet nga Kryetari i Komunës dhe nga përfaqësuesi i Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës (SHSKUK).

- VI. Dhënia në shfrytëzim e pronës së paluajtshme të komunës për raste të veçanta, evidentohet në regjistrin e të drejtave pronësore.
- VII. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Pronës, Gjeodezisë dhe Kadastrore të Komunës së Ferizajt.
- VIII. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet vendimi 01 Nr. 540 i datës 04.02.2003.
- IX. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të ministereve përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e komunës.

Kryesuesja KK-së

Kristina Gashi Bytyci





DREJTORIA E PRONËS, GJEODEZISË DHE KADASTRIT  
UPRAVA IMOVINE, GEODEZIJE I KADASTRA  
DEPARTMENT OF, PROPERTY, GEODEOSY & CADASTAR

DATA/DATUM/DATE	26.06.2018
NR/BR.	10.Nr.463-65

PËR/ZA/TO	Komitetin për Politikë dhe Financa dhe Kuvendin e Komunës
NGA/OD/FROM	Agim Aliu, Kryetar i Komunës 
PËRMES/PREKO/RTHROUGH	Sabri Murseli, Drejtor i Drejtorisë së Pronës, Gjeodezisë dhe Kadastrit 
LËNDA/PREDMET/SUBJECT	<b>PROPOZIM VENDIM PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË TË TOKËS SË KOMUNËS</b>

Në bazë të nenit 58, shkroja h të Ligjit Nr. 03/L-040 për vetëqeverisje lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr. 28/15 qershor 2008), të nenit 7, paragrafi 1 i Ligjit Nr. 04/L-144 për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së palujtshme të Komunës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr. 35/17 dhjetor 2012) të nenit 11 të rregullores QRK Nr. 23/2013 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së palujtshme të komunës, të nenit 51 pika 2.9 të Statutit të Komunës së Ferizajt 01 nr 50 i datës 28.06.2013, Kryetari i Komunës i propozon Kuvendit;

- **PROPOZIM VENDIM PËR DHËNIE NË SHFRYTËZIM AFATGJATË TË TOKËS SË KOMUNËS, NGA STRA KADASTRALE 00708-2, Z.K. FERIZAJ**
- I propozoj Kuvendit të Komunës që të miratojë vendimin për dhënie në shfrytëzim afatgjatë parcelën 00708-2, me sipërfaqe prej 1000 m<sup>2</sup>, Z.K Ferizaj, Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës – Qendrës për Shëndet Mendor me Shtëpi Integruese në Bashkësi - Ferizaj.
- Afati i dhënies në shfrytëzim është për 99 (nëntëdhjetë e nëntë) vite pa pagesë.

- Shfuqizohet vendimi i Kuvendit Komunal 01.Nr.540 i datës 04.02.2003.

### **Arsyetim**

- Me datën 26.06.2018 Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës – Qendrës për Shëndet Mendor me shtëpi Integruese në Bashkësi - Ferizaj ka bërë kërkesë me shkrim që Komuna e Ferizajt, gjegjësisht Kuvendi i Komunës t'ia jap në shfrytëzim afatgjatë parcelën 708-2, Z.K. Ferizaj.
- Sipërfaqja e parcelës 708-2 Z.K Ferizaj është  $S=1000 \text{ m}^2$  dhe është pronë e Komunës së Ferizajt.
- Qëllimi i kërkesës së tyre është ndërtimi i shtëpisë Integruese për rehabilitimin dhe risocializimin e klienteve me qrregullime mendore.
- Drejtoria e Pronës, Gjeodezisë dhe Kadastrit i propozon Kuvendit të Komunës shfuqizimin e vendimit të komunës me numër 01.Nr.540 të datës 04.02.2003 me te cilin Vendim kjo parcelë ishte detinuar për fëmijët dhe femrat përjetuese të dhunës familjare.
- Propozimi i dhënies në shfrytëzim afatgjatë është i bazuar në Ligjin nr 04/L.144, **Ligji për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës.**

*Të bashkangjitura në këtë propozim vendim i gjeni:*

- *Kërkesa e QSHM/SHI - Ferizaj*
- *Skicën e identifikimit*
- *Çertifikat e pronësisë*
- *Vendimin e KK Ferizaj 01.Nr.540 i dates 04.02.2003*